



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.88**

**14 korrik**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MPPT nr.11, datë 3.6.2010	Për software-ët në sistemet e menaxhimit të trafikut ajror ..... 4541
Udhëzim i MPPT dhe MMPAU nr.12, datë 15.6.2010	Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”..... 4548
Udhëzim i MPPT nr.14, datë 17.6.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar ..... 4551
Udhëzim i MPPT nr.15, datë 18.6.2010	Për miratimin e formularit tip të kërkesës, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin dhe formularit të të dhënave, për njësitë e ndërtuara në zonat e stimuluar, me përparësi turizmin ..... 4551
Kërkesë e MPPT nr.3726, datë 17.6.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash..... 4556

**UDHËZIM**  
**Nr.11, datë 3.6.2010**

**PËR SOFTWARE-ËT NË SISTEMET E MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe shteteve të tij anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”, në zbatim ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.401, datë 11.7.2007 “Për miratimin e kërkesave rregullative të Eurocontrol për sigurinë në aviacionin civil shqiptar” si dhe të udhëzimeve, nr.18, 20, 21 dhe 22, datë 16.10.2008 të ministrit të MPPT-së;

UDHËZOJ:

KAPITULLI I

Hyrje

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për implementimin dhe vënien në zbatim të KRRSE 6/ESARR 6 për “Software-t në sistemet në menaxhimin e trafikut ajror”.

2. Organet zbatuese

2.1 Ngarkohet AAC, si organi i ngarkuar edhe me funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës (AKM), të garantoj zbatimin e këtij udhëzimi.

2.2 AAC do të mbikëqyrë dhe do të garantojë zbatimin me përpikmëri të rregullave të vendosura në këtë udhëzim, nga ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror.

2.3 Kërkesat e përgjithshme të këtij udhëzimi do të zbatohen nga departamentet e përcaktuara të aviacionit civil, ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror dhe nga i gjithë personeli i shërbimit të menaxhimit të trafikut ajror (MTA), përgjegjës për detyrat, të cilat janë përcaktuar si të lidhura ngushtë me sigurinë.

2.4 Kërkesat do të zbatohen tek:

Departamentet e përcaktuara të aviacionit civil, organizmat operativë dhe individët e personelit, të cilët ofrojnë shërbime nëpërmjet pajisjeve të MTA të aprovuara për përdorim operacional.

3. Kërkesat e sigurisë

3.1 Kërkesa të përgjithshme

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të garantojë, përmes ushtrimit të auditimeve dhe proceseve rregullatore përkatëse, që organizmat dhe personeli përgjegjës për detyrat në lidhje me shërbimin e trafikut ajror, apo që mbulon fushën e shërbimeve të trafikut ajror, të cilat janë konsideruar të lidhura me sigurinë e trafikut ajror, ka zbatuar detyrat siç janë të përcaktuara në këtë udhëzim.

3.2 Kërkesa të zbatuara nga AAC

AAC është përgjegjëse që:

a) të garantojë mbikëqyrjen e përshtatshme dhe të mjaftueshme të rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) të kryejë, pas hulumtimit përkatës mbi një terren të pranueshëm, veprimin rregullues përkatës në përputhje me specifikimet e këtij udhëzimi dhe me dispozitat e OSHNA.

3.3 Kërkesa të zbatueshme nga OSHNA

Një OSHNA do të:

a) garantojë implementimin e detyrave që i linden atij në bazë të përcaktimeve të këtij udhëzimi;

b) garantojë që, në lidhje me procedurat e përcaktuara nga ky udhëzim, të dhënat që ekzistojnë janë dokumentuar nga OSHNA dhe vihen në dispozicion, me kërkesë të AAC-së;

c) garantojë që, nga një pikëpamje sigurie, metodat përkatëse të zgjedhura janë ato që duhen, për të garantuar plotësimin e dispozitave të zbatueshme të këtij udhëzimi.

#### 4. Përjashtime

Në rastin e ekzistencës së rrethanave që bëjnë të pamundur zbatimin e kërkesave të (KRRSE/ESARR) 6, AAC do të bëjë vlerësimin e tyre dhe më pas do të publikojë zyrtarisht një dokument përjashtimi, i cili do të garantojë një nivel ekuivalent sigurie.

#### 5. Termat e përdorur

5.1 Termat dhe shkurtime të përdorura në këtë udhëzim sqarohen në shtojcën A, bashkëlidhur këtij udhëzimi e cila është pjesë përbërëse e tij dhe do të konsiderohen të detyrueshme.

## KAPITULLI II

### Software-ët në sistemet e MTA

Me anë të këtij udhëzimi vendosen standardet dhe procedurat për zbatimin e programeve të sigurimit të sistemeve të sigurisë, të cilat garantojnë që rreziqet që lidhen me përdorimin e software-it, lidhur me sigurinë në sistemet tokësore të MTA, të reduktohen në një nivel të pranueshëm.

Ky udhëzim nuk përshkruan çdo lloj mjeti mbështetje të pajtueshmërisë për software-t. Ky është roli i standardeve të sigurimit të software-t. Prandaj është jashtë fushëveprimit të kësaj kërkesë të përcaktojë standardet specifike kombëtare ose ndërkombëtare të sigurimit të standardeve të software-it.

Qëllimi i kësaj kërkesë është të ofrojë për organet AKM dhe OSHTA një set kërkesash rregullatore të sigurisë të njësishe dhe të harmonizuara për përdorimin e software-ve në sistemet e MTA.

#### A. QËLLIMI

i) Qëllimi i këtij udhëzimi është që të ofrojë siguri për AKM dhe OSHTA nëpërmjet një grupi kërkesash rregullative të sigurisë të njëtrajtshme dhe të harmonizuar për përdorimin e software-ve në sistemet e MTA.

ii) Kjo kërkesë rregullatore ka lidhje me sigurinë në software-t që përdoren nga OSHTA për trafikun ajror civil, në sistemet tokësore të MTA-së, duke përfshirë të gjitha ndryshimet operative *on-line* të software-ve të tilla si *cutover / hot swapping*.

iii) Shtirirja e kësaj kërkesë rregullatore është e përcaktuar për përbërësit tokësorë të MTA dhe të shërbimeve mbështetëse tokësore, duke përfshirë sistemet KNS, nën kontrollin e menaxhimit të OSHTA. Kjo kërkesë rregullatore nuk mund të zbatohet pa u ndryshuar dhe vlerësuar në mënyrë adekuate, për sistemet ajrore ose pjesë të hapësirës ajrore të sistemeve MTA.

iv) Dispozitat e kësaj kërkesë rregullatore të sigurisë janë zhvilluar mbi bazën e një procesi *a priori* të vlerësimit efektiv të rrezikut dhe procesit të zbutjes të tij, që të zhvillohet në një nivel të duhur për të siguruar që i jepet vëmendje e duhur në të gjitha aspektet të MTA-je duke përfshirë edhe funksionet e MTA që do të kryhet nga software-t.

v) Kjo kërkesë rregullatore nuk përshkruan çdo lloj mjeti mbështetje të pajtueshmërisë së software-it. Ky është roli i standardeve të sigurimit të software-ve. Kjo, në përputhje me rrethanat, është jashtë fushëveprimit të kësaj kërkesë, që të nxjerrë standarde specifike kombëtare apo ndërkombëtare të sigurimit të software-it.

#### B. ARSYETIMI

i) Vendimi 6/8/5 i SRC miraton përfshirjen e zhvillimit të një kërkesë rregullatore sigurie të EUROCONTROL për sistemet e bazuara në software të MTA në programin e punës të SRC. Është vërejtur se nuk ka pasur një të tillë për këtë fushë brenda standardeve dhe praktikave të rekomanduara të ICAO-s.

ii) Udhëzimi i ministrit nr.20, datë 16.10.2008 “Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të sigurisë nga ofruesit e shërbimit MTA”, kërkon që sistemet e menaxhimit të sigurisë të përfshijnë

vlerësimin e rrezikut dhe të zbutjes së tij për të garantuar se funksionet në sistemin e MTA janë vlerësuar për rëndësinë e tyre dhe se të gjitha funksionet e sistemit të MTA janë të klasifikuara sipas rreptësisë së tyre. Kjo gjithashtu kërkon sigurimin e zbutjen e përshtatshme të vlerësimit të rreziqeve, përsa i përket rëndësisë së ndryshimit të kryer.

iii) Udhëzimi i ministrit nr.22, datë 16.10.2008 "Vlerësimi i rrezikut dhe zbutja e tij në MTA" zgjeron udhëzimin e ministrit nr.20, datë 16.10.2008 me kërkesat për vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut, dhe siguron një proces gjithëpërfshirës në sistemin e MTA-së të kapaciteteve njerëzore, procedurave dhe pajisjeve (software dhe hardware) dhe ndërveprimet e tyre kur futet dhe/ose planifikohet një ndryshim në sistemin e MTA-së.

iv) Ky udhëzim është vazhdimi i një procesi rregullator të zhvillimit dhe perfeksionimit të sigurisë dhe zgjeron udhëzimin e Ministrit nr.22, datë 16/10/2008 lidhur me aspektet e software-ve dhe sistemeve të MTA. Kërkesat plotësuese rregullative për siguri në aspektet "hardware" janë nën shqyrtim.

v) Siguria është një karakteristikë themelore e sistemeve të MTA. Ajo ka një ndikim dominues mbi efektivitetin operativ. Sistemet MTA, tani përfshijnë ndërveprime të rëndësishme në një mjedis më të madh dhe në integrim të vazhdueshëm, automatizimi të funksioneve operative të kryera më parë nëpërmjet procedurave manuale, rritje në tërësi, dhe përdorimi masiv dhe sistematik i programeve, kërkojnë një qasje më formale për arritjen e sigurisë.

### C. OBJEKTIVI

Objektivi është ulja në nivele minimale të pranueshme të rreziqeve që lidhen me përdorimin e software-it në sistemet e MTA-së, nëpërmjet mbrojtjes dhe sigurisë për këto sisteme.

### DISPOZITA TË ZBATUESHME

#### 1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR SIGURINË

1.1 Brenda kuadrit të SMS së vet, dhe si pjesë e aktiviteteve të veta për vlerësimin e rrezikut dhe zbutjen e pasojave, OSHTA duhet të përcaktojë dhe të zbatojë një sistem sigurimi të sigurisë së software-ve që merret posaçërisht me aspekte që lidhen me software-t, duke përfshirë të gjitha ndryshimet operative on-line të software-ve (të tilla si cutover/hot swapping).

1.2 OSHTA duhet të garantojë, si minimum, brenda sistemit të sigurimit të sigurisë së software-ve, se:

a) kërkesat ndaj software-it përcaktojnë saktë se çfarë kërkohet nga software-i, në mënyrë që të përmbushen objektivat dhe kërkesat e sigurisë, si identifikohen dhe në dhe nga vlerësimin e rrezikut dhe procesit të zbutjes së tij;

b) dallueshmëria është adresuar në lidhje me të gjitha kërkesat e software-ve;

c) zbatimi i programeve nuk përmban funksione të cilat ndikojnë negativisht mbi sigurinë;

d) Software-t e MTA përmbushin kërkesat për një nivel të besueshmërisë i cili është në përputhje me kriticitetin e software-it;

e) sigurinë që të gjitha kërkesat e mësipërme të përgjithshme të sigurisë, janë të kënaqur, dhe argumentet për të demonstruar sigurimin e kërkuar rrjedhin në çdo kohë nga:

i) një version software-i i njohur dhe i ekzekutueshëm;

ii) një gamë të njohur të të dhënave të konfigurimit, dhe

iii) një set i njohur i produkteve të këtij software-i dhe përshkrimet (duke përfshirë specifikimet) që janë përdorur në prodhimin e këtij versioni.

1.3 OSHTA duhet të garantojë sigurinë e nevojshme, te autoriteti i caktuar AKM, që kërkesat në nenin 1.2 më sipër janë përmbushur.

#### 2. KËRKESA TË APLIKUESHME PËR SISTEMIN E SIGURIMIT TË SIGURISË SË SOFTWARE-VE

OSHTA duhet të sigurojë, si minimum, që sistemi i sigurimit të sigurisë së software-ve:

2.1 Është i dokumentuar, në veçanti, si pjesë e vlerësimit të rrezikut të përgjithshëm dhe zbutjes së tij.

2.2 Cakton nivelet e sigurimit të software-ve për të gjitha programet operative në MTA.

2.3 Përfshin sigurim për:

a) vlefshmërinë e kërkesave të software-ve;

b) verifikim software;

- c) menaxhimin i konfigurimit të software-it dhe
- d) kërkesat e software-it për gjurmëtimin.

2.4 Përcakton rreptësinë mbi të cilën sigurimet janë përcaktuar.

Rreptësia do të përcaktohet për secilin nivel sigurimi të software-it, dhe do të rritet kur rritet kriticiteti në përdorim i software-it . Për këtë qëllim:

a) Ndryshimit në rreptësinë të garancive për nivel sigurimi të software-it duhet të përfshijë kriteret e mëposhtme:

- i) kërkohet të arrihet me pavarësi,
- ii) kërkohet të arrihet,
- iii) nuk kërkohet,

b) Sigurimet përkatëse për çdo nivel të sigurimit të software-ve do të japin besim të mjaftueshëm që software-t e MTA mund të veprojnë në mënyrë të tolerueshme sigurie.

2.5 Përdor feed-back prej përvojës nga përdorimet e software MTA për të konfirmuar se sistemi i sigurimit të sigurisë së Software-ve dhe caktimi i niveleve të sigurimit, janë të përshtatshme. Për këtë qëllim, efektet që rezultojnë nga çdo mosfunksionim apo dështim i software-ve nga përvoja operative në MTA, do të raportohen sipas udhëzimit të ministrit nr.19 datë 16/10/2008, dhe do të vlerësohen sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit nr.22 datë 16/10/2008.

2.6 Ofron të njëjtin nivel të besimit, përmes çfarëdo mjeti të zgjedhur dhe rënë dakord me AKM, për evolucionin ose jo të software-ve të MTA (p.sh. COTS–software jashtë përdorimit komercial etj.) me të njëjtin nivel sigurimi të software-ve.

### 3. KËRKESAT E APLIKUESHME PËR NIVELIN E SIGURIMIT TË SOFTWARE

OSHTA duhet të garantojë, si minimum, brenda sistemit të sigurimit të sigurisë së software, që:

3.1 Nivel i sigurimi të software-ve lidh ashpërsinë në sigurimin e software-ve me kriticitetin e software-ve të MTA duke përdorur Skemën e Klasifikimit të Rreptësisë sipas udhëzimit nr.22, datë 16.10.2008, së bashku me gjasat e një efekti të caktuar negativ që mund të ndodhë. Katër nivele të sigurimit të software-ve do të identifikohen, ku me siguri software-i të nivelit 1 tregohet niveli më kritik.

3.2 Një nivel i caktuar sigurimi të software-it do të përlllogaritet sipas efekteve më negative që një mosfunksionim ose dështim i software-it mund të shkaktojë, sipas udhëzimit nr.22, datë 16.10.2008. Kjo duhet të marr parasysh rrezikun bashkëngjitur me mosfunksionimin ose dështimin, dhe projektimin me/ose procedurat e mbrojtjes të identifikuara.

3.3 Të gjithë përbërësit e software-ve të MTA që nuk mund të jenë të pavarur nga njëri-tjetri do t'u përcaktohet niveli i sigurimit të software-ve sipas nivelit më kritik nga përbërësit e varur të këtij software-i.

### 4. KËRKESA E APLIKUESHME PËR VLEFSHMËRINË E SIGURIMIT TË SOFTWARE-it

OSHTA duhet të garantojë, si minimum, brenda sistemi i sigurimit të sigurisë së software-it, se kërkesat për sigurinë:

4.1 Specifikojnë një sjellje funksionale (nominale dhe mënyra të reduktuara) të software-ve të MTA, sipas përmbushjes në kohë kërkesave, kapacitetin, saktësinë, burimeve të përdorimit të software-ve në hardware-t përkatës, fortësinë në kryerje të veprimeve në kushte anormale funksionimi dhe tolerance mbingarkimi.

4.2 Janë të plotë dhe të saktë, dhe janë gjithashtu në përputhje me kërkesat për sistemin e sigurisë.

### 5. KËRKESAT PËR VERIFIKIMIN E SIGURIMIT TË SOFTWARE-it

OSHTA duhet të sigurojë, si minimum, brenda sistemit të sigurimit për sigurinë e software-it që:

5.1 Mënyra e funksionimit të software-ve të MTA, përmbush në kohë kapacitetin, saktësinë, përdorimet e software-ve në hardware-t përkatës, fortësinë në kryerjen e veprimeve në kushte anormale funksionimi dhe tolerance mbingarkimi, si dhe i bindet kërkesave për software-t.

5.2 Software-t e MTA janë verifikuar në mënyrë përkatëse nga analiza dhe/ose testime dhe / ose mjete ekuivalent, siç është rënë dakord për ato me AKM.

5.3 Verifikimi i software-ve të MTA është i saktë dhe i plotë.

## 6. KËRKESAT PËR SIGURIMIN E MENAXHIMIT TË KONFIGURIMIT TË SOFTWARE-ve

OSHTA duhet të sigurojë, si minimum, brenda sistemit të sigurimit për sigurinë e software-it që:

6.1 Identifikim të konfigurimit, gjurmim dhe përcaktim statusit ekziston në mënyrë të tillë që të dhënat gjatë përdorimit të software-it mund të tregojnë që janë nën kontrollin e konfigurimit gjatë gjithë ciklit të jetës së software-it të MTA.

6.2 Raportimi i problemeve, ndjekja dhe veprimet korrigjuese ekzistojnë të tilla që problemet lidhur me sigurinë e software-it mund të tregohet që janë zbutur.

6.3 Korrigjim dhe procedura kalimi ekzistojnë të tilla që të dhënat e ciklit jetësor të software-it mund të rigjenerohen dhe dërgohen gjatë gjithë ciklit të jetës të software-it të MTA.

## 7. KËRKESAT PËR SIGURIMIN E GJURMËTIMIN E SOFTWARE-ve

OSHTA duhet të sigurojë, si minimum, brenda sistemit të sigurimit për sigurinë e software-it që:

7.1 Çdo kërkesë e software-it është gjurmuar sipas nivelit të njëjtë të projektimit dhe për të cilin plotësimi i këtyre kërkesave demonstron.

7.2 Çdo kërkesë e software-it, në çdo nivel të projektimit për të cilin plotësimi i këtyre kërkesave demonstron, gjurmohet sipas kërkesës së sistemit.

## 8. APLIKIMI

8.1 Kjo kërkesë rregullatore e sigurisë duhet të zbatohet nga OSHTA civil dhe ushtarak të cilët kanë përgjegjësinë për menaxhimin e sigurisë të sistemeve MTA në tokë, si dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në tokë (përfshi KNS) që ata kanë nën kontroll.

8.2 Sistemi i sigurimit të sigurisë të software tashmë ekzistues për sistemet e MTA nën kontroll të drejtpërdrejtë menaxhimin nga organizata MTA ushtarake mund të pranohet, me kusht që t'i përmbahet dispozitave të detyrueshme të këtij udhëzimi të Ministrit të MPPT.

8.3 Dispozitat e detyrueshme të këtij udhëzimi të Ministrit do të miratohen si kërkesat kombëtare minimale rregullatore të sigurisë.

## 9. PËRKUFIZIMET

Termat dhe përkufizimet e përdorura janë listuar në shtojcën A.

## 10. HYRJA NË FUQI.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**

## SHTOJCA A

### 1. TERMA DHE PËRKUFIZIME

Në funksion të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

AAC – Autoriteti i Aviacionit Civil. Autoriteti rregullator kompetent në varësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe është përgjegjës për rregullat dhe rregulloret e sigurisë së aviacionit.

Saktësi. Saktësia e kërkuar e rezultateve të llogaritura.

Arritur me pavarësi. Shiko përcaktimin e pavarësisë.

Vlerësim. Një vlerësim i bazuar mbi metoda inxhinierike, gjykimin operacional dhe/ose analiza.

MTA. Grupimi i funksioneve në tokë (duke përfshirë ATS, ASM, ATFM të ndryshme) dhe në ajër që kërkojnë të ofrojnë sigurinë dhe lëvizjen efikase të avionit gjatë të gjitha fazave përkatëse të veprimeve.

Pajisja MTA e miratuar për përdorimin operacional. Të gjitha sistemet inxhinierike, ndërtesat ose pajisjet që janë përdorur si nga përdoruesit e hapësirave ajrore (p.sh. ndërtesa për lëvizjen në tokë) drejtpërdrejtë ose përdoren në ofrimin e shërbimeve operacionale për menaxhimin e trafikut ajror.

Shërbimi MTA. Një shërbim për qëllim të MTA.

Ofruesi i shërbimit të MTA. Një organizatë përgjegjëse dhe e autorizuar për të ofruar shërbimin (et) MTA.

Programi i MTA. Programi i përdorur në mjedisin e MTA. Shikoni më poshtë për përcaktimin e programit.

Sistemi MTA. Një pjesë e një sistemit SHNA të përbërë nga elementi MTA me bazë në tokë dhe elementin e MTA me bazë ajrin.

KNS. Komunikim, navigim dhe survejim. Të dhënat e konfigurimit verifikimi i plotë dhe i saktë i programit MTA. Të dhëna që konfigurojnë një sistem programi të përgjithshëm për kërkesë të caktuar të përdorimit të tij (për shembull, të dhëna që përshtatin një sistem përpunimi të dhënash fluturimi në një hapësirë ajrore të caktuar, duke caktuar pozicionet e rrugëve ajrore, aeroportet dhe elemente të tjera të rëndësishëm për fluturimin). Të gjithë kërkesat e programit konstatojnë me saktësi se çfarë kërkohet nga përbërësi i programit nga vlerësimi i riskut dhe procesi i uljes së tij dhe implementimi i tyre provohet në nivelin e kërkuar nga niveli i sigurimit të programit. Prandaj, përbërësi i programit do të mbetet njëjloj i sigurt sikurse kërkohet nga UM Nr22 datë 16/10/2008

Cutover (Hot Swapping). Metoda e zëvendësimit të përbërësve të sistemit ose programit KNS/MTA ndërsa sistemi është operacional.

Rrezik. Çdo kusht, ngjarje ose rrethanë që mund të çojnë në një incident.

Pavarësi. Për veprimtaritë e procesit të verifikimit të programit, pavarësia arrihet kur veprimtaritë e procesit të verifikimit kryhen nga një person (a) tjetër nga zhvilluesi i një elementi që verifikohet; një mjet mund të përdoret për të arritur një barazvlefshmëri me veprimtarinë e verifikimit njerëzor

Përbërës programi të pavarur. Hapa të marra për të kontrolluar ose parandaluar një rrezik për të mos shkaktuar dëme ose ulin riskun në një nivel të pranueshëm ose të lejuar.

Element moszhvillimi-NDI. Një element (program) i pazhvilluar nga kontrata (programi) e tanishme (programi).

Shënim: Kjo është e barazvlefshme me përcaktimin e mësipërm të zhvillimit të programit në DO-178B/ED-12B. Ajo mund të konsiderohet si një COTS.

Programi operativ. Programi që përdoret në pajisjen MTA të miratuar për përdorimin operacional. Shikoni më sipër përcaktimin për pajisjen MTA të miratuar për përdorim operacional.

Toleranca e mbingarkesës. Sjellja e sistemit në rastin e, dhe veçanërisht toleranca e saj, inputeve që ndodhin me një normë më të madhe se sa ajo që pritet gjatë operimit normal të sistemit.

Përdorimi i burimit. Sasia e burimeve brenda sistemit kompjuterik që mund të përdoret nga programi i aplikimit.

Shënim: Burimet mund të përfshijnë memorien e përgjithshme të kategorive të ndryshme (si të dhëna statike, memorien dinamike dhe grupimet), hapësirën në disk dhe gjerësinë e brezit të komunikimit dhe mund të përfshijnë burime të brendshme të programit si numri i skedarëve që mund të hapen njëkohësisht.

Risku. Kombinimi i probabilitetit të përgjithshëm ose frekuencës së ndodhjes së një efekti të dëmshëm nga një rrezik dhe ashpërsia e atij efekti.

Vlerësimi i riskut. Vlerësimi për të vendosur që risku i arritur ose i dalluar është i pranueshëm ose i tolerueshëm

Zbutje e riskut. Shiko mitigim/zbutje

Siguria. Parrezikshmëri nga risku i papranueshëm

Arritja e sigurisë. Rezultati i proceseve ose metodave të zbatuara për të arritur sigurinë e pranueshme ose të tolerueshme.

Garancia e sigurisë. Të gjithë veprimet sistematike dhe të planifikuara të nevojshme për të ofruar besimin e duhur që një produkt, shërbim, organizatë ose një sistem arrin sigurinë e pranueshme ose tolerueshme.

### Sistemi i menaxhimit të sigurisë (SMS)

Një metodë sistematike dhe e qartë që përcakton veprimtaritë sipas të cilave ndërmerret menaxhimi i sigurisë nga një organizatë në mënyrë që të arrijë sigurinë e pranueshme ose të tolerueshme.

Kërkesat e rregullatorit për sigurinë. Hartimi formal nga rregullatori i një sigurie që lidhet me një specifikim që, nëse përmbushet do të çojë një njohjen e aftësisë së sigurisë lidhur me të.

Programi. Programe kompjuterike dhe të dhënat përkatëse të konfigurimit, që përfshijnë programe të pazhvilluara (p.sh. programe të regjistruara, programe tregtare që nuk janë në shitje (COTS), programe të ripërdorura etj.), por duke përjashtuar elemente elektronike si aplikimi i qarqeve të integruar elektronik të caktuar, dyer të programueshme ose kontrollor llogjik në gjendje të ngurtë.

Aftësia e programit. Aftësia e programit për të përballuar sasinë e rrjedhjes së të dhënave.

Përbërësit e programit. Një përbërës që mund të shikohet si një bllok ndërtimi që mund të ngjitet ose lidhet së bashku me blloqet e tjera të programit për t'u kombinuar dhe krijuar një aplikacion programi të caktuar.

Dështimi i programit. Paaftësia e programit për të kryer korrekt një funksion të kërkuar.

Jetëgjatësia e programit. 1. Një përmbledhje e porositur procesesh të përcaktuara nga një organizatë për të qenë e aftë dhe e përshtatshme për të prodhuar një produkt programi.

2. Periudha e kohës që fillon me vendimin për të prodhuar ose modifikuar një produkt programi dhe që përfundon kur produkti tërhiqet nga shërbimi.

Jetëgjatësia e të dhënave të programit. Të dhëna që prodhohen gjatë jetëgjatësisë së programit për të planifikuar, shpjeguar, përcaktuar, regjistruar ose ofruar prova të veprimtarive. Kjo e dhënë lejon proceset e jetëgjatësisë së programit, miratimet e sistemit ose pajisjes dhe ndryshimet pas miratimit të produktit të programit.

Kërkesat e programit. Një përshkrim i asaj që është për t'u prodhuar nga programi duke pasur inputet dhe përmbajtjet dhe nëse përmbushen, do të sigurojnë që programi i MTA të funksionoj i sigurt dhe sipas nevojave operacionale.

Fortësia e programit. Sjellja e programit në rastin e inputeve të paparashikuara, dështimeve të pajisjes dhe ndërprerjes së energjisë elektrike si në vetë sistemin kompjuterik ose në pajisjet e lidhura.

Integriteti i sigurisë së programit. Masa që tregojnë mundësinë e programit në arritjen e funksionit të tij nën të gjitha kushtet e caktuara brenda një periudhe të caktuar kohore.

Rendimenti i koordinimit të programit. Koha e lejuar për programit që t'i përgjigjet inputeve të dhëna ose ngjarjeve periodike dhe/ose rendimentit të programit në terma të transaksioneve ose mesazheve të përballura në njësi kohe.

Shërbime mbështetëse. Sistemet, shërbimet dhe rregullimet, duke përfshirë shërbimet e Komunikimit, Navigimit dhe Survejimit, që mbështetin dhënien e shërbimit të një MTA.

Kërkesat e programit. Kërkesat e sigurisë që rrjedhin për një sistem.

Kërkesat e sigurisë. Mjetet e minimizimit të riskut, përcaktuar nga strategjia e minimizimit të riskut, që arrin një objektiv të caktuar sigurie. Kërkesat e sigurisë mund të marrin forma të ndryshme, duke përfshirë rendimentin organizativ, operacional, procedural, funksional dhe kërkesat ndërvepruese ose karakteristikat e mjedisit.

Objektivi i sigurisë. Objektivi i sigurisë është arritja e një sigurie të planifikuar. Arritja e një objektivi mund të tregohet nga mënyrat e përshtatshme që përcaktohen në marrëveshjen me rregullatorin e sigurisë. Objektivi i sigurie është një deklaratë sasiore ose cilësore që përcakton frekuencën maksimale ose probabilitetin sipas të cilës pritet që të ndodhi një rrezik.

Vlefshmëria e kërkesave. Konfirmimi sipas ekzaminimit dhe dhënia e provave objektive që tregojnë se një kërkesë e caktuar për një përdorim të dhënë janë sikurse menduar.

Verifikimi. Konfirmimi nga ekzaminimi i provave që një produkt, proces ose shërbim përmbush kërkesat e specifikuar



## SHKURTIME

1. AKM	Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës
2. SHNA	Shërbimi i navigimit ajror
3. OSHNA	Ofruesit e shërbimit të navigimit ajror
4. SHTA	Shërbimi i trafikut ajror
5. SHKTA	Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror
6. KTA	Kontrolli i tafikut ajror
7. AAC	Autoriteti i aviacionit civil
8. MTA	Menaxhimi i trafikut ajror
9. KNS	Komunikim, navigim dheurvejim
10. UM	Udhëzim ministri
11. SRC	Komisioni i Rregullave të Sigurisë
12. SMS	Menaxhimi i sistemeve të sigurisë
13. ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
14. Eurocontrol	Agjencia Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror

## UDHËZIM

Nr.12, datë 15.6.2010

### **MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6527, DATË 24.12.2004 “MBI VLERAT E LEJUESHME TË ELEMENTEVE NDOTËSE TË AJRIT NË MJEDIS NGA SHKARKIMET E GAZRAVE DHE ZHURMAVE SHKAKTUAR NGA MJETET RRUGORE DHE MËNYRAT E KONTROLLIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të nenit 79 dhe 222 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 373 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

#### UDHËZOJNË:

##### Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

Organet e DPSHTRR gjatë kryerjes së procedurave të regjistrimit për herë të parë të mjeteve rrugore sipas udhëzimit të MTT-së nr.3551, datë 23.7.2003 “Për regjistrimin e mjeteve rrugore”, në procesin e regjistrimit të mjetit rrugor të kontrollojnë dokumentacionin teknik mbi gjendjen e shkarkimeve të gazrave dhe zhurmave të shkaktuara prej tij, të cilat duhet të jenë jo më lart se limitet e përcaktuara në këtë udhëzim. Në rast të kundërt nuk bëhet regjistrimi i mjetit rrugor.

##### Neni 2

Neni 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

Vlerësimi i gjendjes teknike të mjetit rrugor për efekt të ndotjes së ajrit nga shkarkimet e gazrave, janë pjesë përbërëse e procesit të kontrollit teknik të mjeteve rrugore, kryerja e të cilit disiplinohet me udhëzimin nr.2, datë 12.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

### Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

Mënyrat e kontrollit për matjen e nivelit të vlerave të elementeve ndotëse që emetohen nga shkarkimet e gazrave, kryhen duke respektuar operacionet e përcaktuara në “Manualin e kontrollit të mjeteve” miratuar me udhëzimin nr.2, datë 12.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe ato të rekomanduara nga prospektet teknike të aparaturave të kontrollit të destinuara për këtë qëllim (gazoanalizator, smokmetër, opacimetër, fonometër) të homologuara sipas rregullave të KE-së.

### Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë vijon:

Mjetet rrugore që kalojnë në kontrollin teknik të radhës, fillimisht kryejnë në QKT kontrollin e nivelit të shkarkimeve të elementeve ndotëse. Mbi bazën e rezultateve të këtij kontrolli dhe të rezultateve të gjendjes teknike të mjetit pas kalimit të tij në të gjitha proceset e kontrollit teknik, gjykohet dhe veprohet për lejimin ose kthimin e mjetit sipas procedurave të përshkruara në udhëzimin nr.2, datë 12.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

### Neni 5

Paragrafi i parë në nenin 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

Në rastin kur nga ky kontroll rezulton se niveli i vlerave të elementeve ndotëse që shkarkohen me gazrat është më i lartë se vlerat limite të lejuara që jepen në tabelën 1, atëherë gjendja e mjetit rrugor, referuar “Manualit të kontrollit të mjeteve”, konsiderohet me defekt.

### Neni 6

Neni 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

Mbas eliminimit të defekteve nga servisi, mjeti rrugor paraqitet për kontroll në QKT dhe sipas rezultateve që jepen të printuara nga aparati i matjes së gazrave, nëse rezulton në rregull sipas normave të lejuara, pajiset me certifikatën e kontrollit teknik.

### Neni 7

Neni 18 ndryshohet si më poshtë vijon:

Në të gjitha QKT të mbahet regjistër i veçantë, në të cilin evidentohen rezultatet e kontrollit të mjeteve që kryhen për nivelin e elementeve ndotëse nga mjetet rrugore që kalojnë në procesin e kontrollit teknik të radhës. Modeli i këtij regjistri është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

### Neni 8

Neni 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

Mbi bazën e këtij udhëzimi, DPSHTRR dhe subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit hartojnë sqarues për veprimet që kryen personeli i regjistrimit në çdo drejtori rajonale dhe personeli në çdo QKT. Gjithashtu marrin masa për prodhimin dhe shpërndarjen e modeleve të dokumentacionit, pjesë përbërëse e udhëzimit.

### Neni 9

Neni 20 ndryshohet si më poshtë vijon:

Subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit organizon punën për marrjen e të dhënave që rezultojnë nga matjet e kryera gjatë kryerjes së shërbimit të kontrollit të

mjeteve rrugore nga çdo QKT, si dhe i evidenton në mënyrë të përmbledhur këto rezultate, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve për gjendjen e ndotjes së ajrit nga mjetet rrugore, duke hartuar raportet përkatëse vjetore, të cilat i dërgohen Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

#### Neni 10

Neni 21 ndryshohet si më poshtë vijon:

Për qëllimin e zbatimit të nenit 20, subjekti i autorizuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të programojë ndërtimin e bankës së të dhënave (data base) për evidentimin e rezultateve të matjeve të shkarkimeve, në procesin e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

#### Neni 11

Tabela 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

#### VLERAT LIMIT TË ELEMENTEVE NDOTËSE QË SHKARKOHEN ME GAZET NGA MJETET RRUGORE NË PËRDORIM

Nr.	Viti i prodhimit	Lënda djegëse	Regjimi i punës së motorit rrot/min	CO% vol	HC ppm	Lambda	Kategoria e mjetit
-----	------------------	---------------	-------------------------------------	---------	--------	--------	--------------------

A. Mjete rrugore me ndezje të detyruar

a) Pa konvertor katalitik

1.	Para 1.10.1986	Benzinë	Në boshllëk	4.5	1000	-	M1, N1
2.	1.10.1986+30.12.1993	- "-	- "-	3.5	750	-	- "-

b) Me konvertor katalitik dhe sondë lambda

3	1.1.1994+1.7.2002 Pas 1.7.2002	Benzinë - "-	Në boshllëk	0,5	300	-	M1, N1
			me ngarkesë 2500	0,3	250	-	
			Në boshllëk	0,3	200	1±0.3	
			me ngarkesë 2500	0,2	200		

B.Mjete rrugore me vetndezje

Nr.	Viti i prodhimit	Lënda djegëse	Motor diesel	Koeficienti i absorbimit k m-1	Kategoria mjetit
1.	Para 1.7.2008	Diesel	Thithja natyrale	2.5	Të gjitha kategoritë M,N
	- "-	- "-	me turbokompresor	3.0	
2.	Pas 1.7.2008	Diesel	Thithje natyrale	1.5	Të gjitha kategoritë M,N
	- "-	- "-	me turbokompresor	1.5	

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT  
Sokol Olldashi

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
Fatmir Mediu

**UDHËZIM**  
**Nr.14, datë 17.6.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1649, DATË 16.8.1999 “MBI PLOTËSIMIN E DISA KUSHTEVE TË VEÇANTA NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës nenit 9 dhe paragrafit të parë të nenit 36 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Neni 1

Pika 8 e kapitullit IV shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**

**UDHËZIM**  
**Nr.15, datë 18.6.2010**

**PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TIP TË KËRKESËS, PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN DHE FORMULARIT TË TË DHËNAVE, PËR NJËSITË E NDËRTUARA NË ZONAT E STIMULUARA, ME PËRPARËSI TURIZMIN**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 4 germa a, 5 germa a dhe nenit 7 pika 1 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1. Kërkesat e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, paraqiten respektivisht sipas formularit 1 dhe formularit 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe përmbajnë:

a) Gjeneralitetet e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin.

b) Të dhëna mbi marrëveshjen e qirasë/zhvillimit.

c) Vendndodhjen e njësisë së ndërtuar dhe emërtimin e zonës së stimuluar.

d) Të dhënat ndërtimore të njësisë së ndërtuar, si dhe të dhëna të tjera lidhur me funksionin dhe sipërfaqen e truallit për të cilën kërkohet kalimi i së drejtës së pronësisë.

e) Dokumentacionin që disponon subjekti i interesuar/personi i stimuluar, në përputhje me kërkesat e nenit 4 dhe 5 të ligjit nr.10 186/2009:

i) kontratën e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar (vetëm në rastin e subjektit të interesuar);

ii) marrëveshjen e qirasë apo të zhvillimit të lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit (vetëm në rastin e personit të stimuluar);

iii) lejen e ndërtimit për njësinë e ndërtuar (vetëm në rastin e personit të stimuluar);

iv) planimetrinë dhe sipërfaqen në m<sup>2</sup> të njësisë së ndërtuar;

v) dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;

vi) kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrimit tregtar.  
f) Nënshkrimin, adresën e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, si dhe një numër kontakti.

2. Kërkesat për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, shoqërohen nga dokumentacioni financiar që vërteton shlyerjen e tarifës së aplikimit dhe paraqiten pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t, ku regjistrohen.

3. Të dhënat e përftuara nga administrimi i kërkesave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, pasqyrohen në formularin e të dhënave, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, i cili plotësohet, administrohet dhe ruhet nga një format dixhital.

4. Formulari i të dhënave do të përmbajë elemente që lidhen me:

a) Datën e paraqitjes së kërkesës.

b) Të dhëna mbi personin e stimuluar, apo gjeneralitetet e subjekteve të interesuara.

c) Të dhënat e tipit të marrëveshjes së lidhur me qiradhënësin.

d) Adresën e zonës së stimuluar/njësisë së ndërtuar.

e) Të dhënat e gjendjes ndërtimore të njësisë së ndërtuar.

f) Indeksën e dokumentacionit të pronësisë që disponohet për njësinë e ndërtuar.

g) Të dhëna të tjera të karakterit ndihmës.

5. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për verifikimin e gjendjes juridike dhe në terren të truallit të njësisë ndërtimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**





## FORMULARI 1

### KËRKESË

PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN E NJËSISË SË NDËRTUAR

SUBJEKTI I INTERESUAR 1) \_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër

2) \_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër

EMËRTIMI I ZONËS SË STIMULUAR DHE VENDNDODHJA E NJËSISË SË NDËRTUAR

---

TË DHËNAT E NJËSISË SË NDËRTUAR

Sipërfaqja e bazës së njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Numri i kateve \_\_\_ dhe funksioni i njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Bashkëlidhur kërkesës gjendet:

1. Kontrata e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar
2. Planimetria e njësisë së ndërtuar
3. Dokument pronësie për njësinë e ndërtuar
4. Dokument identifikimi ose ekstrakt i regjistrimit tregtar

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër Firmë

Adresa e kërkuarit \_\_\_\_\_ Numër kontakti \_\_\_\_\_

KËRKESË

PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN E NJËSISË SË NDËRTUAR

PERSONI I STIMULUAR 1) \_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër  
2) \_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër

MARRËVESHJA E QIRASË/ZHVILLIMIT NR \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
NR \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_

TË DHËNAT E NJËSISË SË NDËRTUAR

Emërtimi i zonës së stimular dhe vendndodhja \_\_\_\_\_  
Sipërfaqja e bazës së njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>  
Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>  
Numri i kateve dhe funksioni i njësisë së ndërtuar \_\_\_\_\_  
Sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Bashkëlidhur kërkesës gjendet:

1. Marrëveshja e qirasë dhe/ose zhvillimit
2. Leja e ndërtimit të njësisë së ndërtuar
3. Planimetria e njësisë së ndërtuar
4. Dokument pronësie për njësinë e ndërtuar
5. Dokument identifikimi ose ekstrakt i regjistrimit tregtar

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Emër Mbiemër Firmë

Adresa e kërkuesit \_\_\_\_\_ Numër kontakti \_\_\_\_\_



**KËRKESË**  
**Nr.3726, datë 17.6.2010**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria së Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit objekt: vlerësuar në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Për pronarin për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Rikonfirmim”, sqarojmë se nuk është i qartë konfirmimi nga ZRPP lidhur me numrin e pasurisë, për këtë arsye pas publikimit do të rikërkohet konfirmim pranë kësaj zyre.

Për pronarin për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces legalizimi”, sqarojmë se do të kompensohet për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi dhe regjistrimit pranë ZRPP-së respektive.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 10 472 761 (dhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**  
**Sokol Olldashi**

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT  
RRUGOR “RRËSHEN-REPS-THIRRË”

Nr.	Pronari			ZK	Nr.pas	Vlera lekë	Fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Dedë		Laska			2285970	Shtrungaj	Rikonfirmim
2	Frok	Prend	Biba	3883	182,4	2420338	Zall- Xhuxh	Proces legalizimi
3	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/8	1111031	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
4	Zef	Ndue	Luka	2933	145/1	1408629	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
5	Mark	Preng	Prenga	3259	106	3096130	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
	Gjet	Nikoll	Pershqefa	1190	60	150663	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
		<b>Totali</b>				<b>10472761</b>		

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 13.7.2010

Doli nga shtypi më 14.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë